



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 81/2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 29/2023
“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 24 e nenit 3 ndryshohet si më poshtë:

“24. “Kripto-aset” është një përfaqësim digjital i një vlere ose të drejte, i cili mund të transferohet e mund të ruhet elektronikisht përmes përdorimit të teknologjisë së regjistrave të shpërndarë ose teknologjive të ngjashme.”.

Neni 2

Pas shkronjës “d” të nenit 8 shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) përjashtimisht nga përcaktimet e shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij neni, artistët, të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Shqipërisë nuk do të konsiderohen rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë prej 24 (njëzet e katër) muajsh nga data e hyrjes për herë të parë në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht ditëve të qëndrimit.”.

Neni 3

Pas shkronjës “f” të nenit 11 shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“g) të ardhurat nga sponsorizimet deri në masën e përcaktuar në shkronjën “p” të pikës 1 të nenit 50 të këtij ligji.”.

Neni 4

Pas nënndarjes “ii” të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 12 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Ky rregull nuk zbatohet nëse individ i vetëpunësuar, pavarësisht të ardhurave të përfituara, sipas përcaktimeve të nënndarjeve “i” dhe “ii” të shkronjës “ç”, vetëdeklaron, në deklaratën e statusit të vetëpunësuarit, pranë drejtorisë tatimore rajonale, ku është i regjistruar, se nuk është në kushtet e të ardhurave nga punësimi. Deklarata e statusit të vetëpunësuarit është sipas modelit në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij ligji, dhe dorëzohet në të njëjtën periudhë me deklaratën e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi, brenda muajit mars të vitit tatimor. Kjo deklaratë shërben si mjet vlerësimi nga administrata tatimore, sipas ligjit të procedurave tatimore, për të përcaktuar nëse individ i vetëpunësuar nuk është në kushtet e shmangies tatimore.”.

Neni 5

Pas pikës 1 të nenit 40 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Të ardhurat nga sponsorizimet deri në masën e përcaktuar në shkronjën “p” të pikës 1 të nenit 50 të këtij ligji nuk konsiderohen të ardhura të tatueshme të korporatës.”.

Neni 6

Në shkronjën “p” të pikës 1 të nenit 50 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nënndarjen “ii” fjalia e dytë zëvendësohet me fjalinë si më poshtë:

“Shumat e sponsorizuara, brenda kufirit të mësipërm për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të organizatave sportive, federatave sportive, komiteteve olimpike, si dhe sportistëve të nivelit të lartë, të cilët kanë fituar tituj për meritë në sport, të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës, për efekt të përlogaritjes së tatimit mbi fitimin e periudhës tatimore, janë të zbritshme sa trefishi i vlerës së shumës së sponsorizuar.”.

2. Nënndarja “iii” riformulohet si më poshtë:

“iii. që tejkalojnë masën 5 për qind të fitimit para tatimit për sponsorizimin e aktiviteteve për kërkim dhe zhvillim, të cilat ndërmerren me qëllim përfitimin e njohurive të reja për zhvillimin e shkencës e të teknologjisë dhe aplikimit të tyre nëpërmjet inovacionit në produkte ose në shërbime;”.

3. Pas nënndarjes “iii” shtohet nënndarja “iv” me këtë përmbajtje:

“iv. që tejkalojnë masën 3 për qind të fitimit para tatimit për sponsorizimet e veprimtarive të tjera, që nuk përfshihen në nënndarjet “i”, “ii” dhe “iii” të kësaj shkronje.”.

Neni 7

Kudo në përmbajtje të ligjit fjalët “mjete virtuale” zëvendësohen me fjalën “kripto-aset”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Niko PELESHI

Miratuar në datën 11.12.2025

Shtojca nr. 1

DEKLARATA E STATUSIT TË VETËPUNËSUARIT

1. Periudha tatimore për të cilën bëhet deklarimi: _____
2. Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT) i të Vetëpunësuarit: _____
3. Emri Tregtar i të Vetëpunësuarit: _____
4. Adresa: _____

5. Ky formular plotësohet për subjektet kontraktuese të individit të vetëpunësuar, i cili vetëdeklaroi se është në kushtet e të ardhurave nga biznesi, si më poshtë vijon:

- plotësohet për 1 kontraktues në rastin kur 80 për qind ose më shumë e të ardhurave të fituara merren direkt ose indirekt nga një klient i vetëm; ose
- plotësohet për 2 kontraktues në rastin kur 90 për qind ose më shumë e të ardhurave totale të fituara merren nga më pak se 3 klientë.

6. Ky formular nuk plotësohet nëse individi i vetëpunësuar ofron shërbime vetëm për persona jorezidentë në Republikën e Shqipërisë apo vetëm për entitete që nuk kanë një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë. Në këtë rast, i vetëpunësuari automatikisht konsiderohet se realizon të ardhura nga biznesi dhe nuk është e nevojshme të plotësojë Deklaratën.

7. Përshkruani profesionin tuaj.

8. Përshkruani llojin e shërbimeve të ofruara.

9. Ku e zhvillon aktivitetin tuaj? Ambienti është i marrë me qira, njësi biznesi në pronësinë tuaj, është adresa juaj e banimit, etj? Jepni shpjegime.

10. Sa është vlera totale e të ardhurave të tatueshme të deklaruar në Deklaratën e Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi të periudhës tatimore, për të cilën po vetëdeklarohet Deklarata e Statusit të Vetëpunësuarit?

Kontraktuesi nr. 1

Seksioni 1 - Të dhënat bazë për kontraktuesin e të vetëpunësuarit

1. NIPT-i i Kontraktuesit nr. 1 të vetëpunësuarit: _____

2. Emri Tregtar: _____
3. Adresa: _____
4. Vlera e faturimit pa TVSH të kontraktuesit për individin e vetëpunësuar: _____

Seksioni 2 - Informacion i Përgjithshëm

5. Përcaktoni kohëzgjatjen e shërbimit të ofruar.
-

6. Përshkruani biznesin e kontraktuesit nr. 1, të cilit i faturoni shërbimin.
-

7. Përshkruani detyrat/funksionet e kryera në kuadër të shërbimit të ofruar për kontraktuesin nr. 1.
-

Seksioni 3 - Sjellja e të vetëpunësuarit

8. A është i vetëpunësuar i detyruar të raportojë mbi punën e tij? Nëse po, përcaktoni nëse raportimi bëhet mbi bazë ditore, javore, mujore, etj.
-

9. Cila është frekuenca e shërbimeve? Përcaktoni nëse është ditore, javore, sipas nevojës, sipas një kalendari në ditë të dakordësuara, etj.
-

10. A është i vetëpunësuar i detyruar të ofrojë shërbimin personalisht? ____ Po ____ Jo (*Jepni shpjegime*)
-

11. A është e mundur që i vetëpunësuar të punësojë zëvendësues apo ndihmës për dhënien e shërbimit? ____ Po ____ Jo (*Jepni shpjegime*)
-

12. A përcaktohet mënyra e proceseve të punës dhe sekuenca e tyre nga biznesi kontraktues? ____ Po ____ Jo (*Jepni shpjegime*)
-

13. A ka rregullore apo instruksione në bazë të të cilave i vetëpunësuar i është i detyruar të kryejë shërbimet sipas këtyre rregullave apo instruksioneve të përcaktuara nga biznesi kontraktues?

14. A i reklamoni shërbimet e veta i vetëpunësuar i? ____ Po ____ Jo, nëse po në çfarë forme?

15. A është i vetëpunësuar i detyruar t'i kryejë shërbimet sipas orareve të përcaktuara nga kontraktuesi?

Seksioni 4 - Kontrolli mbi faktorët dhe produktin e shërbimit

16. Listoni materialet që duhen për ofrimin e shërbimit. A janë ofruar këto materiale nga individ i vetëpunësuar apo nga biznesi kontraktues?

17. Listoni pajisjet që duhen për ofrimin e shërbimit. Këto pajisje janë ofruar nga i vetëpunësuar apo nga biznesi kontraktues?

18. Ku ofrohen shërbimet? Në vendin e biznesit të të vetëpunësuarit, në vendin e biznesit të marrësit të shërbimit, diku tjetër. (Jepni shpjegime)

19. A i proceson i vetëpunësuar i një pjesë të produktit të shërbimit në ambientet e tij? ____ Po ____ Jo,

Nëse po, përshkruaj shërbimin, materialet, pajisjet e përdorura.

Nëse po, çfarë bën i vetëpunësuar i me produktin apo shërbimin e përfunduar?

Seksioni 5 - Natyra e Marrëdhënies

20. A është kryer puna sipas një kontrate? ____ Po ____ Jo
Nëse po, përshkruani kushtet e kontratës, datën dhe palët, nr/prot të noterizimit nëse ka.

21. A është i vetëpunësuar i detyruar të kryejë shërbimet sipas orareve të përcaktuara nga biznesi kontraktues? ____ Po ____ Jo (Jepni shpjegime)

22. Çfarë lloj pagese merr i vetëpunësuar? Shpjegoni nëse pagesa është me orë pune, javore, mujore, etj.

23. Kush vendos për vlerën e pagesës apo tarifës: i vetëpunësuar, biznesi kontraktues? (Jepni shpjegime)

24. A është e mundur që i vetëpunësuar të pësojë humbje financiare nga performanca në zbatim të kësaj kontrate? ____ Po ____ Jo (Jepni shpjegime)

25. Nëse shërbimet nuk realizohen sipas afateve të përcaktuara, a ka penalitete për vonesat? ____ Po ____ Jo (Jepni shpjegime)

Kontraktuesi nr. 2

Seksioni 1 - Të dhënat bazë për kontraktuesin e të vetëpunësuarit

1. NIPT-i i Kontraktuesit nr. 1 të vetëpunësuarit: _____
2. Emri Tregtar: _____
3. Adresa: _____
4. Vlera e faturimit pa TVSH të kontraktuesit për individin e vetëpunësuar: _____

Seksioni 2 - Informacion i Përgjithshëm

5. Përcaktoni kohëzgjatjen e shërbimit të ofruar.
-

6. Përshkruani biznesin e kontraktuesit nr. 2, të cilit i faturoni shërbimin.

7. Përshkruani detyrat/funksionet e kryera në kuadër të shërbimit të ofruar për kontraktuesin nr. 2.

Seksioni 3 - Sjellja e të vetëpunësuarit

8. A është i vetëpunësuar i detyruar të raportojë mbi punën e tij? Nëse po, përcaktoni nëse raportimi bëhet mbi bazë ditore, javore, mujore, etj.

9. Cila është frekuenca e shërbimeve? Përcaktoni nëse është ditore, javore, sipas nevojës, sipas një kalendari në ditë të dakordësuara, etj.

10. A është i vetëpunësuar i detyruar të ofrojë shërbimin personalisht? ____ Po ____ Jo (*Jepni shpjegime*)

11. A është e mundur që i vetëpunësuar të punësojë zëvendësues apo ndihmës për dhënien e shërbimit? ____ Po ____ Jo (*Jepni shpjegime*)

12. A përcaktohet mënyra e proceseve të punës dhe sekuenca e tyre nga biznesi kontraktues? ____ Po ____ Jo (*Jepni shpjegime*)

13. A ka rregullore apo instruksione në bazë të të cilave i vetëpunësuar është i detyruar të kryejë shërbimet sipas këtyre rregullave apo instruksioneve të përcaktuara nga biznesi kontraktues?

14. A i reklamoni shërbimet e veta i vetëpunësuar? ____ Po ____ Jo, nëse po në çfarë forme?

15. A është i vetëpunësuar i detyruar t'i kryejë shërbimet sipas orareve të përcaktuara nga kontraktuesi?

Seksioni 4 - Kontrolli mbi faktorët dhe produktin e shërbimit

16. Listoni materialet që duhen për ofrimin e shërbimit. A janë ofruar këto materiale nga individ i vetëpunësuar apo nga biznesi kontraktues?

17. Listoni pajisjet që duhen për ofrimin e shërbimit. Këto pajisje janë ofruar nga i vetëpunësuar apo nga biznesi kontraktues?

18. Ku ofrohen shërbimet? Në vendin e biznesit të të vetëpunësuarit, në vendin e biznesit të marrësit të shërbimit, diku tjetër. (Jepni shpjegime)

19. A i proceson i vetëpunësuar një pjesë të produktit të shërbimit në ambientet e tij? ____ Po ____ Jo

Nëse po, përshkruaj shërbimin, materialet, pajisjet e përdorura.

Nëse po, çfarë bën i vetëpunësuar me produktin apo shërbimin e përfunduar?

Seksioni 5 - Natyra e Marrëdhënies

20. A është kryer puna sipas një kontrate? ____ Po ____ Jo
Nëse po, përshkruani kushtet e kontratës, datën dhe palët, nr/prot të noterizimit nëse ka.

21. A është i vetëpunësuar i detyruar të kryejë shërbimet sipas orareve të përcaktuara nga biznesi kontraktues? ____ Po ____ Jo (Jepni shpjegime)

22. Çfarë lloj pagese merr i vetëpunësuar? Shpjegoni nëse pagesa është me orë pune, javore, mujore, etj.

23. Kush vendos për vlerën e pagesës apo tarifës: i vetëpunësuar, biznesi kontraktues? (Jepni shpjegime)

24. A është e mundur që i vetëpunësuar të pësojë humbje financiare nga performanca në zbatim të kësaj kontrate? ____ Po ____ Jo (Jepni shpjegime)

25. Nëse shërbimet nuk realizohen sipas afateve të përcaktuara, a ka penalitete për vonesat? ____ Po ____ Jo (Jepni shpjegime)

Nënshkrimi i Vetëdeklarimit

Deklaroj se pas vlerësimit të pyetjeve të Deklaratës së Statusit të Vetëpunësimit nuk jam në situatë shmangie tatimore në kuptim të nenit 12, shkronja “ç”, të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe si rrjedhojë të ardhurat e deklaruara, do të deklarohen si të ardhura nga biznesi në Deklaratën e Tatimit mbi të Ardhurat Personale të Biznesit për periudhën tatimore të vitit

Individi i Vetëpunësuar
(Emër, Mbiemër, Nënshkrim)